REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 638/20
Datë/Datum. 07/09/2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA E GJAKOVËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**632-19-7809-2-1-1**
Nr i brendshëm	**632-18-072-211**

Sa i përket tenderit për: **Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa e I-rë - Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane**

1.Identifikimi i ankuesit*

SH.Drini Company SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prizren

(Adresa)

Prizren ***20000***

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38344122673

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Fatmir Gashi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

driniasphalt@yahoo.com

(Adresa elektronike)

SH. DRINI COMPANY SH.P.K. PRIZREN

07.09.2020
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 16.10.2019 Hapja e ofertave dt. 05.11.2019 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 26.08.2020 Kërkesa për rishqyrtim:31.08.2020 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 01.09.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 24 pika 2 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 64 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Rregullat dhe Udhëzimet Operative

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me dt.26.08.2020 jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku çuditërisht ka rekomanduar për kontratë OE Viktori Com, ndërsa neve na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Me dt.26.08.2020 ne kemi kërkuar qasje ne dokumentet e Operatorëve ekonomik të rekomanduar për dhënie te kontratës, ndërsa qasja na është lejuar me dt. 27.08.2020.

Siç e dini edhe ju, ky aktivitet i prokurimit është stërzgjatur shumë me procese të ankimimit, ndërsa me këtë veprim të AK-ja përsëri ka vepruar në atë drejtim që të shkohet me procedura të ankimimit. Kur e themi këtë bazohemi në faktin se OE i rekomanduar për kontratë dy herë në vlerësimet e AK-së është shpallur i papërgjegjshëm, ndërsa tani e ka rekomanduar për kontratë.
Në raportet e vlerësimit të dt.05.12.2019 dhe në raportin e rivlerësimit të dt. 21.04.2020 OE Viktori Com ishte shpallur me të drejtë i papërgjegjshëm.

Me qasjen tonë në dokumente kemi vërejtur se grupi i rekomanduar për dhënie të kontratës "Company Murseli"Sh.p.k & N.SH.T.Viktory Com janë të pa përgjegjshëm, dokumentet të cilat i mungojnë këtij grupi janë:

Ne deklaratën e Konzorciumit thuhet që kompania N.SH.T.Viktory Com është lideri ndërsa ne lidhjen e ofertës shohim qe lider është kompania "Company Murseli" Sh.p.k. Duke u bazuar në këto fakte atëherë rezulton se lideri i konzorciumit Viktory Com nuk e ka plotësuar kërkesën për 60 % të vlerës së kontratave të ngjashme.

Grupi i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk ka arritur të dëshmoj se ka kontrata të natyrës së ngjashme si dhe referenca mbi kryerjen e punimeve. Kompania N.SH.T.Viktory Com ka paraqitur tri referenca të cilat janë referenca të pa vlefshme.

Referenca me kompaninë Grand Construction Sh.p.k nga komuna e Ferizajt, është referencë e cila i përmbahet disa rrugëve të cilat nuk kanë as emër, as numër, referenca është pa datë dhe ka një shumë prej 150,000.00 Euro. Kjo referencë që të jetë në rregull duhet të paraqitet edhe Situacioni mbi kryerjen e punimeve gjithashtu edhe fletëpagesat faturat etj. I njëjti problem qëndron edhe tek referencat tjera të cilat kompania në fjalë i ka paraqitur si punë të kryera. Referenca me kompaninë Art Construction referencë e cila është e dy viteve 2018-2019, gjithashtu kësaj reference i mungojnë situacionet mbi përfundimin e punimeve dhe faturat ose transaksionet bankare mbi kryerjen e shërbimeve të cilat kinse kompania N.SH.T.Viktory Com i ka kryer ndaj kompanisë Art Construction.
I njëjti problem qëndron dhe me referencën tjetër të cilën kompania N.SH.T.Viktory Com e ka paraqitur me kompaninë Gjeo-Projekt Sh.p.k nga Rahoveci e cila i ka lëshuar referencë për largimin e Borës dhe shpërndarjen e krypës, gjithashtu kësaj reference i mungojnë edhe procesverbalet edhe faturat mbi pagesat ose transaksionet bankare për punët e kryera.

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, aty shkruan se AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë për të tri këto kontrata, ndërsa sipas AK-së me dt.13.08.2020 i ka ngarkuar në sistem dokumentet e ngarkuara. Kontrata e ofruar me Grand Construction Sh.p.k nga komuna e Ferizajt nuk është e nënshkruar dhe e vulosur (dhe është e shkëputur me nene), për më shumë kompania Grand Construction Sh.p.k është kompani në emër të pronarëve apo familjarëve të Murseli Company, e që rezulton qartë se kjo kontratë është fiktive dhe nuk mund të dëshmohet në asnjë mënyrë që këto punë janë kryer, kur dihet që Viktory Com është në konzorcium me Murseli Company, ndërsa kompania Grand Construction Sh.p.k po ashtu është e Murseli Company.
Në referencë shkruan se Viktory Com ka kryer punët në lëminë e ndërtimtarisë dhe ndërtimin e rrugëve, ndërsa është absurde të kryej punë Viktory Com për kompaninë e cila merret vet me ndërtim të rrugëve siç është Murseli Company. Në referencë shkruan se ka kryer punë për Grand Construction, mirëpo për të vërtetuar nëse ekziston kjo lidhje atëherë duhet prezantuar kontrata e Grand Construction me institucionin KK Kaçanik dhe marrëveshjen apo njoftimin se është angazhuar si nënkontraktor Viktory Com dhe më pastaj transaksionet bankare ndërmjet këtyre dy kompanive. Gjithashtu duhet kërkuar se sa ka qenë vlera e kontraktuar me KK Kaçanik sepse është në interes të dihet se sa përqind eventualisht paska kryer punë Viktory Com, sepse me LPP nuk lejohet më shumë se 40 % të nënkontraktohet puna.

Te gjitha këto pa qartësi ne i kemi paraqitur në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në organet kompetente tek Krimet Ekonomike. Ne dyshojmë qe këto punë nuk janë kryer asnjëherë dhe po dëmtojnë seriozisht konkurrencën në tender, dhe qe dikush duhet të merr përgjegjësin për këtë. Prandaj kërkojmë nga ana juaj që të detyroni autoritetin kontraktues që të verifikoj seriozisht këto dëshmi të ofruara nga konzorciumi i rekomanduar për kontratë. Thjesht të kërkohen transaksionet bankare për këto kontrata fiktive, në të kundërtën do të zbardhen nga organet tjera kompetente.

Konzorciumi i rekomanduar për kontratë po ashtu nuk ka arritur te dëshmojë se ka punëtorë te mjaftueshëm për realizimin e kontratës. Kompania "Murseli" Sh.p.k ka paraqitur një listë me 20 punëtorë ndërsa ne listën e paraqitur nga Administrata Tatimore e Kosovës kemi pa që kjo kompani i ka vetëm 10 të punësuar. Konzorciumi ne fjalë nuk i ka paraqitur kontratat e punëtorëve siç janë kërkuar ne FDT.

Konzorciumi në fjalë nuk ka arritur të dëshmojë qe i ka Paisjet e Makineritë për realizimin e projektit, ai ka paraqitur listën nga dosja e tenderit duke e shënuar në pronësi dhe në marrëveshje me El Bau pa plotësuar të dhënat e makinerive po vetëm i ka shënuar marrëveshjet. Të gjitha marrëveshjet për makineri të paraqitura nga konzorciumi janë marrëveshje të cilat nuk i përmbushin kushtet edhe kriteret e dosjes se tenderit.

Marrëveshja me El Bau nuk jep të dhëna për specifikat teknike të pajisjeve që kontraktohen, prandaj kjo marrëveshje nuk është në harmoni me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa në këtë rast nuk lejohet të kërkohen as sqarime shtesë sepse dëshmitë eventuale që do të ofroheshin nuk mund të verifikohen në mënyrë objektive ashtu siç e parasheh neni 72.3 i LPP-së.10

Se nuk ka ofruar dëshmi për këto marrëveshje të cekura e ka konstatuar edhe paneli shqyrtues në vendimin Nr. 939,952/20 të dt.10.02.2020, prandaj është shumë e qartë se ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet automatikisht.

*Kontrata e makinerive me kompaninë "Gurbardhi"Sh.p.k është kontratë pa datë, pa emrin e projektit, pa numrin e prokurimit si dhe pa specifikimin e makinerive, prandaj kjo kontratë është e pavlefshme dhe nuk duhet të llogaritet si dokument ligjor dhe i rregullt.

*Kontrata e makinerive me Linder Hasanaj e paraqitur nga kompania N.SH.T. Viktory Com është kontratë për: Multicar me shpërndarës Kripe ndërsa ne dokumentet e paraqitur aty shohim qe është një kamionetë me targa 07-685-AU, që është automjet i ç'regjistruar me dt. 21.08.2019, prandaj nuk duhet të llogaritet si dëshmi konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë..

*Kontrata e makinerive me kompaninë Minerel L.L.C. është kontratë pa emër të projektit pa nr. te prokurimit, pa datë dhe pa specifikacione te makinerive siç është kërkuar në FDT, prandaj edhe kjo kontratë nuk duhet të llogaritet si e vlefshme dhe si e rregullt.

Makineritë të cilat i mungojnë Konzorciumit për rekomandim për dhënie te kontratës janë :

- ☐ 4 Kamion me mekanizëm për pastrim te borës dhe me shpërndarës te kripës.
- ☐ 2 Pastrues të borës me mekanizëm të shpërndarjes së kripës I vogël (min).

Mungesa e këtyre dëshmive ishte konstatuar edhe në rivlerësimin e dt.21.04.2020, pasi ishin kërkuar sqarime nga ky konzorcium por që i njëjti nuk kishte arritur të dëshmojë që dokumentet dhe dëshmitë e ofruara ishin konform kërkesës së dosjes së tenderit të përcaktuara në nenin 9.1&9.2 të FDT-së, prandaj ishte eliminuar edhe për këtë arsye.
Pra konzorciumi i rekomanduar për kontratë ishte shpallur i papërgjegjshëm për arsyen që u cek më lartë, e po ashtu ishte shpallur i papërgjegjshëm edhe me arsyen se nuk ka ofruar dëshmi të

mjaftueshme lidhur me pajisjet e kërkuara (edhe pse kishin kërkuar sqarime shtesë) dhe pas këtij rivlerësimi ky konzorcium nuk kishte parashtruar ankesë, duke u pajtuar me këto arsye të eliminimit. Në mungesë të këtyre dëshmive ky OE është dashur të eliminohet dhe të shpallet i papërgjegjshëm sikurse ishte shpallur edhe dy herët dhe në dy vlerësimet e kaluara nga vetë autoriteti kontraktues.
Këto mangësi ishin evidentuar edhe në raportin e parë të vlerësimit të dt.05.12.2019. Pra në dy vlerësime dhe raporte të vlerësimeve të cilat janë nënshkruar edhe nga vetë menaxheri i prokurimit konzorciumi Viktory Com&Mursely Company është shpallur i papërgjegjshëm, ndërsa për çudi tani ky konzorcium është shpallur i përgjegjshëm dhe fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.
Në këtë aktivitet të prokurimit është bërë një ndryshim ekstrem i madh në raport me vlerësimin e konzorciumit të rekomanduar për kontratë, pra ka ndodh një favorizim ekstrem në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.
AK-ja ka përdorur standarde të dyfishta dhe të çuditshme, sepse në vlerësimet e kaluara edhe pse kishte kërkuar sqarime dhe i'u ishin ofruar nga ky konzorcium në fjalë sqarimet, AK-ja nuk ishte bindur se ka ofruar dëshmi konform kërkesave të FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa tani është bindur në lidhje me kontratat dhe referencat, mirëpo për pajisje AK-ja nuk ka kërkuar sqarime fare. Në lidhje me pajisjet tanimë AK-ja nuk ka kërkuar fare sqarime por çuditërisht i ka marr si të vlefshme dëshmitë, të cilat dëshmi në dy vlerësime të kaluara nuk i ka pranuar.

Mungon Deklarata për Specifikacione Teknike

Konzorciumi i rekomanduar për kontratë është shpallur i përgjegjshëm në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 ku shkruan: Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një Tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit, sepse oferta e këtij konzorciumi dhe dëshmitë e ofruara nga ky konzorcium nuk janë në përputhshmëri të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

OE tani i rekomanduar për kontratë Viktory Com normalisht është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së sepse i njëjti faktikisht është pajtuar me rivlerësimin e kaluar kur është shpallur i papërgjegjshëm dhe nuk është ankuar fare, e që nga ky fakt kuptohet se vetë ky OE është pajtuar me arsyet e eliminimit në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Sa i përket arsyeve të eliminimit të OE D&T Group SH.P.K ne pajtohemi me ato konstatime sepse i njëjti OE është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar dëshmi për kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit ne vlerë prej 350.000.00 euro.

Ne me dt. 01.09.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues në arsyetimin për refuzimin e kërkesës tonë nuk i ka sqaruar fare pretendimet tona ankimore duke u arsyetuar se i kanë rishikuar dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe kanë konstatuar se ky OE i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, mirëpo vetë fakti se AK-ja nuk i ka arsyetuar fare pretendimet tona ankimore tregon qartë se pretendimet tona ankimore janë të bazuara dhe se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet qe u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Po ashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë duke e rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **OE *SH.Drini Company SH.P.K*** si e bazuar
ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM.**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.000 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*